



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INFORMIMIT PUBLIK
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1798 / Prot.
13

Patos, më 12 / 06 / 2025

NJOFTIM

Dëgjese publike me temë:

“Plani i mbarështimit të ekonomisë pyjore- Ana e lumit Seman 2”

Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës me nr. 1675 prot., datë 02.06.2025 të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit.

Ju njoftojmë se:

Ditën e **Mërkurë** në datë **16.07.2025 ora 10³⁰** në ambientet e sallës së Këshillit Bashkia Patos do të organizohet konsultimi publik me përfaqësues të: Anëtarë të Këshillit Bashkiak; kryetarë të fshatrave; grupe interesi; banorë të bashkisë Patos dhe njësisë administrative Ruzhdie dhe Zharrëz; shoqëri civile; përfaqësues të bashkisë Patos; institucione publike dhe jopublike; OJF dhe grupe interesi me temë: **“Plani i mbarështimit të ekonomisë pyjore- Ana e lumit Seman 2”**.

Ky konsultim publik synon të njoh grupet e interesit, institucionet publike dhe jopublike, OJF dhe qytetarë lidhur me analizën e situatës, qëllimin e planit, objektivat dhe marrjen e mendimeve dhe komenteve mbi planin e hartuar.

Komentet dhe rekomandimet e grupeve të interesit janë të mirëpritura, brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik në adresën e email-it: info@bashkiapatos.gov.al.

Pjesëmarrja juaj në këtë dëgjese publike është shumë e rëndësishme për garantimin e një procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.



KRYETARI
Faton Duro